

ROMEO DHE ZHULIETA- William Shakespeare

Karakteristika të veprës së Shakespeare:

1) Lënda e parë merret nga e shkuara (legjenda, kronika, etj.)

2) Përcjellin **parimet e Rilindjes**:

- Njeriu me aftësitë dhe cilësitë e tij në qendër të gjithçkaje
- Humanizmi
- Emancipimi
- Iluminizmi
- Dituria
- Virtyti mbizotëron mbi vesin
- Çlirimi i mendjes njerëzore nga dogmat

3) Gjetjet artistike: fantazma, drama brenda dramës, marrëzia e shtirur e Hamletit, çmenduria e vërtetë e Ofelisë, kafka e Jorikut, etj.

4) Struktura si tragjedia klasike antike

Skeda e jashtme

Autori: William Shakespeare

Titulli: Romeo dhe Zhulieta

Botimi: Periudha e rinisë (1588-1595)

Skeda e brendshme

Konteksti: ngjarja zhvillohet në një kohë të re, që kërkon të shkëputet nga mesjeta e errët, e cila si ka zhdukur akoma gjurmët e saj dhe i ka lënë institucionet fetare e laike në krizë.

Tema kryesore: Historia e dashurisë së dy të rinjve, familjet e të cilëve janë në hasmëri me njëra-tjetrën

Konflikti kryesor: Konflikti shoqëror, moral dhe fetar

Personazhet: Romeo, Zhulieta, Frati Laurens, Tibalti, Markuti, Parisi, Zonja Kapulet, Vaja, Princi, Kapuleti, Montagu, Benvoli, Samsoni, Gregori, etj.

Koha reale: Shekulli XVI

Koha letrare: Fundi i Mesjetës

Vendi: Verona, Itali

Mesazhi kryesor: Dashuria e Romeo dhe Zhuljetës është një simbol i dashurisë, të cilën çdokush do të donte ta kishte të tijën. Ajo është një dashuri me vlera universale.

Struktura: Tragjedia përbëhet nga pesë akte, ku i pari ka pesë skena, i dyti ka gjashtë, i treti dhe i katërti nga pesë dhe i pesti ka tre skena.

Romeo dhe Zhulieta, vepër e Rilindjes

“Romeo dhe Zhulieta” i përket Periudhës së Rinisë të krijimtarisë të Shakespeare dhe është ndër të parat e Letërsisë së Rilindjes. Ajo është e çliruar nga dogmat fetare. Në dialogët dhe monologët e tragjedisë nuk ka asnjë shenjë të forcave të mbinatyrshme apo të dorës së Zotit apo perëndive.

Personazhet e kanë vetë në dorë fatin e tyre. Ata janë të ndërgjegjshëm për veprimet, që bëjnë, i marrin parasysh pasojat dhe e kanë në dorë të kontrollin e jetës së tyre.

Vërtetësia është një tjetër karakteristikë, që na vjen përmes sjelljeve, fjalëve, ndjenjave të sinqerta e të vërteta. Personazhet janë njerëz normalë, të marrë nga jeta reale.

Shakespeare vë **në qendër të veprës njeriun** dhe e sheh atë në të gjitha dimensionet. Ai na e sjell njeriun me të gjitha të mirat dhe të këqijat njerëzore: me mërinë, dashurinë, sakrificën, gëzimet, festat, zënkat, etj. Kjo e bënë “Romeo dhe Zhuljetën” një vepër humaniste.

Për të vazhduar me **romantizmin** në vepër, që na vjen prej deklaratave poetike dhe elegante të Romeos, i cili është një tipar dallues rilindas. Kjo, sepse Romeoja është thjesht një njeri, të cilin autori e vendos në qendër të veprës me ndjenjat e tij, që janë fare reale e të zakonshme.

Letërsia Rilindase **goditi errësirën e Mesjetës**. Këtë, Shakespeare e bënë duke filluar që nga institucioni i familjes, për të vazhduar me kishën e më pas me Princin, institucione këto që ishin në një krizë të thellë.

Githashtu, rilindasit i kthejnë sytë nga Letërsia Antike, duke i dhënë veprave të tyre **karakteristikat e krijimtarive të antikitetit**. Kështu, sikurse dhe të gjitha tragjeditë antike, “Romeo dhe Zhulieta” është shkruar në **pesë akte**. Kryepersonazhet tragjike i ndjekin një sërë **situatash të pakëndshme**, që do t’i çojnë drejt **fatit të tyre të pakthyeshëm**. Në fund, ata janë të gatshëm të **sakrifikojnë**, të **marrin përsipër përgjegjësitë** dhe të **paguajnë për veprimet e tyre**.

Megjithatë, pavarësisht **fundit tragjik të paracaktuar**, heronjtë **kryesorë luftojnë për një ideal të lartë**, që në fund e arrijnë, por nuk e jetojnë.

Letërsia Rilindase trajton **tema me karakter universal**, siç është dashuria. Gjithashtu, **personazhet e saj kryesorë i përkasin shtresave të larta të shoqërisë**.

Çfarë do t'i ndryshonte veprës “Romeo dhe Zhulieta”, nëse fundi do të ishte i lumtur?

Zhulieta dhe Romeo janë simbol i dashurisë me vlera universale, të cilën çdokush do të donte ta kishte. Dashuria e tyre jetoi për një kohë fare të shkurtër dhe fitoi përjetësinë vetëm pas vdekjes fizike të dy të rinjve. Të gjithë do të ndjeheshim të lumtur, nëse Romeo dhe Zhulieta do të kishin një fund të lumtur. Po përse Shakespeare e vendosi veprën e tij në sfondin e tragjedisë?

Kjo ndodhi, sepse tragjedia nuk ishte e vetëm dy të rinjve. Nëpërmjet fatalitetit të tyre, autori godet tragjizmin e periudhës së errët mesjetare. Nëse ajo do të kishte një fund të lumtur, nuk do të ishte në lartësinë, që është sot, sepse do të humbiste shumë nga vlerat e saj.

Së pari, do të shndërrohej në një ngjarje të rëndomtë dhe shumë nga virtytet njerëzore, siç është sakrifikimi dhe forca e dashurisë, do të humbisnin e nuk do të mund të na vinin aq reale e madhështore.

Për të vazhduar më tej, ajo nuk do të ishte vepër e Rilindjes, nëse fundi do të ishte i lumtur. Kështu, vepra nuk do ta godiste mesjetën dhe nuk do të na vinte me mesazhet e saj të fuqishme.

Pra, nëse “Romeo dhe Zhulieta” do të mbyllej lumturisht, ajo nuk do të ishte një vepër madhështore, nga e cila do të nxirrnin mësim të mëdha brezat e të gjitha kohërave. Ajo është një mishërim i vërtetë i Parimit të Katharsasit, ashtu siç është.